

KNF - Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor Faza II - KRK (EFSD+1)

Shteti:	KOSOVË
Projekti Nr.:	56202
Spektori i biznesit:	Kredi jo-depozitare (jo-bankare)
Lloji i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	FI
Data e Synuar e Aprovimit:	04 mars 2025
Statusi:	Aprovuar
DPP i shpalosur:	10 mars 2025

Përshkrimi i Projektit

Sigurimi i një huaje senior të pasiguruar deri në 3 milionë euro për KRK-në për huadhënie të mëtutjeshme për NVM të udhëhequra nga gratë në përputhje me kriteret e Programit Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor Faza II ("WB WiB II").

Objektivat e Projektit

Projekti do të kontribuojë në përfshirjen ekonomike të grave duke mbështetur qasjen e NVM-ve të udhëhequra prej grave në financim dhe shërbime këshilluese të biznesit.

Ndikimi i Tranzicionit

ETI 68

Projekti kontribuon në objektivat e Fazës II të WB WiB II, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si Gjithëpërfshirës dhe Konkurrues. Projekti do të kontribuojë në përfshirjen ekonomike të grave duke mbështetur qasjen e NVM-ve të udhëhequra prej grave në financa dhe shërbime këshillimore për biznesin, duke demonstruar edhe argumente afariste për rritjen e shkallës së huadhënies për segmentin e NVM-ve të udhëhequra prej grave. Ndikimi i tranzicionit pritët gjithashtu të rrjedhë nga zgjerimi i tregut në përputhje me Kornizën për Ndërmjetësues Financiarë të BERZH-it.

Informata për Klientin

KREDITIMI RURAL I KOSOVËS SHPK

Kreditimi Rural i Kosovës, SHPK ("KRK") është institucioni i tretë më i madh mikrofinanciar për nga huatë bruto në Kosovë, me mision që të sigurojë qasje në financim për NMVM-të lokale. Në VF 2024, KRK-ja u ka shërbyer pothuajse 26,000 klientëve në mbarë territorin e Kosovës përmes rrjetit të vet prej 29 degësh dhe 287 të punësuarish.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

2,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

2,000,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është klient ekzistues i BERZH-it. Sipas ekspozimeve ekzistuese, performanca e vet mjedisore dhe sociale (MS) është në pajtueshmëri me Kërkesat e Performancës 2, 4 dhe 9 të Politikës Mjedisore dhe Sociale (PMS) 2019. Sipas PMS-së 2024, KRK-ja duhet të jetë në pajtueshmëri me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale 2, 4 dhe 9 dhe Listën e BERZH-it për Përrjashtimet për MS. IMF-ja do të duhet gjithashtu të dorëzojë raporte vjetore për MS tek BERZH-i. Nën-huamarrësit e financuar nëpërmjet huave të KRK-së duhet të përmbushin rregulloret kombëtare të mjedisit, shëndetit, sigurisë dhe punës.

Nëse financimi i BERZH-it përdoret për nën-projekte solare ku mund të ketë risqe më të larta të punës së detyruar në zinxhirin e furnizimit, këto nën-projekte duhet të menaxhohen sipas Deklaratës së Politikës së BERZH-it.

Bashkëpunimi Teknik

Programi për BT i WiB Faza II mbështetet nga SSF-ja dhe nga Be-ja përmes EFSD+. Fondet për BT do të sigurojnë ngritje të kapaciteteve si për KRK-në ashtu edhe për NVM-të e udhëhequra prej grave.

Shtueshmëria

Projekti do të mbështesë segmentin e tregut në tërësi dhe do të mundësojë vazhdimin e zbatimit të suksesshëm të projektit të mëparshëm WiB.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Lulzim Sadrija
Lulzim.sadrija@krk-ks.com
 +383 38243554

<http://krk-ks.com/en/>

Rr. Behije Dashi, p.n. Ndërtesa D. 10000 Prishtinë Kosovë

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikatat e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.